



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1698/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve- të Inspektoratit të Punës në Mitrovicë, të cilin e përfaqëson V.M., kundër debitorit “Telekomi i Kosovës” Sh.A, me NRB:811288001, me seli në Prishtinë, - njësia në Vushtrri, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2151/22 të datës 31.09.2023, me datën 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit “Telekomi i Kosovës” Sh.A, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2151/22 të datës 31.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2151/22 të datës 31.09.2023, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Telekomi i Kosovës” Sh.A, dhe është anuluar pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.949/22 i datës 27.07.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Atip Mustafa, për pjesën e kamatës ligjore prej 8% në vit në bazë të LMD-së. Në pikën II ka lënë në fuqi pjeën tjetër të Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.949/22 i datës 27.07.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Atip Mustafa, me të cilën është caktuar përmbarimi, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 1,500.00 € (njëmijë e pesëqind euro). Ndërsa në pikën III ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbarimore të kreditorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës ndaj debitorit “Telekomi i Kosovës” Sh.A, sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.949/22 i datës 27.07.2022, për pjesën e kamatës ligjore prej 8% në vit në bazë të LMD-së.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përbarimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që urdhri përbarimor të shfuqizohet në tërësi ose aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në shkallë të parë në rivendosje.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve- të Inspektoratit të Punës në Mitrovicë me datën 27.07.2022 ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përbarimor - Vendimit 02 Nr.22-165/2021 B, të datës 14.10.2021, me të cilën është urdhëruar debitori që të bëjë kompensimin e borxhit kryesor dhe shpenzimeve të përbarimit duke përfshirë edhe pagesën e kamatë-vonesës në vlerë prej 8 % në vit në bazë të LMD-së në të kundërtën do të bëhet ndalimi i mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogari bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e Përbaruesit Privat, si dhe regjistrimi, vlerësimi, sekuestrimi ose shitja e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Përbaruesi privat Atip Mustafa nga Vushtrria, me urdhrin përbarimor P.nr.949/22 i datës 27.07.2022,, ka lejuar përbarimin, me të cilën detyrohet debitori që në emër të masës ndëshkimore - gjobës, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1500 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Kundër urdhrin përbarimor debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor duke theksuar se në vazhdimësi ka pasur mospajtime me kreditorin dhe i njëjti nuk është njoftuar me kohë me vendimin e kreditorit.

Ndaj prapësimin të debitorit kreditori nuk ka parashtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimin ka nxjerrë aktvendimin P.nr.949/22 i datës 27.07.2022, me të cilin në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Telekomi i Kosovës” Sh.A, dhe është anuluar pjesërisht Urdhri për lejimin e përbarimit P.nr.949/22 i datës 27.07.2022, i lejuar nga Përbaruesi Privat Atip Mustafa, për pjesën e kamatës ligjore prej 8% në vit në bazë të LMD-së. Në pikën II ka lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrin për lejimin e përbarimit

P.nr.949/22 i datës 27.07.2022, i lejuar nga Përmbauesi Privat Atip Mustafa, me të cilën është caktuar përmbauesi, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 1,500.00 € (njëmijë e pesëqind euro). Ndërsa në pikën III ka përfunduar pjesërisht procedurën përmbauese të kreditorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës ndaj debitorit “Telekomi i Kosovës” Sh.A, sipas Urdhrit Përmbaues P.nr.949/22 i datës 27.07.2022, për pjesën e kamatës ligjore prej 8% në vit në bazë të LMD-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbauese kur ka refuzuar propozimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbauesit privat, me të cilin është caktuar përmbauesi i propozuar nga kreditori. Kjo gjykatë vlerëson se – Vendimi 02 Nr.22-165/2021 B, të datës 14.10.2021, i lëshuar nga Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve- të Inspektoratit të Punës në Mitrovicë është dokument përmbaues dhe i përshtatshëm për përmbaues, për faktin se me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: “ *Dokument përmbaues është edhe vendimi përmbaues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (me tej: ujdia)* ” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbauesit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 sepse, po ashtu është në pajtim edhe me nenin 27 paragraf 1 të LPP i cili përcakton se: “ *Dokumenti përmbaues është i përshtatshëm për përmbaues në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit* ”, ndërsa një dokument përmbaues për të shërbyer si titull përmbaues patjetër duhet të përmbajë elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përmbaues. Në bazë të këtij neni del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbaues të papërshtatshëm për përmbaues.

Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se Vendimi 02 Nr.22-165/2021 B, të datës 14.10.2021, i lëshuar nga Inspektorati i Punës në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve- të Inspektoratit të Punës në Mitrovicë është dokument i përmbaueshëm dhe i cili vendim është i plotfuqishëm dhe është i ekzekutueshëm nga data 10.05.2022, ashtu që si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbaues, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet ligjore, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e detyrimit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit.

Gjykata e shkalles se dytë ka vlerësuar edhe nenin 36 paragraf 1 të LPP - së, ku përcakton se “ *Së bashku me propozimin për përmbaues, organit përmbaues i dorëzohet edhe dokumenti përmbaues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbaueshmërisë për përmbaueshmëri*”, ndërsa në paragrafin 2, të po këtij neni përcaktohet se “ *Vërtetimin për përmbaueshmëri e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë* ”. Në rastin konkret kemi të bëjmë me vendim administrativ të formës së prerë, i njëjti është origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet për përmbaues. Arsye këto nga të cilat edhe kjo gjykatë vlerëson se pretendimet e debitorit janë të paargumentuara dhe si të

tilla mbeten vetëm ne natyrën deklarative , te pambështetura ne prova ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, me çka nuk janë plotësuar as kushtet ligjore nga neni 71 te LPP.

Sa i përket pikës I dhe III të dispozitivit gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka shfuqizuar pjesërisht urdhrin sa i përket pjesës së kamatës së kërkuar prej 8% pasi që debitori sipas dokumentit përmbarimor është obliguar që në emër të masës ndëshkimore t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,500.00€ (njëmijë e pesëqind euro), mirëpo jo edhe pjesën e kamatës ligjore.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1698/23, me datë 05.03.2024**

**Gjyqtari
Faton Bajrami**